



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

01 Nr. 268/12  
Më: 27/09/12

## PROCESVERBAL

### Nga mbledhja e VII-të për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në Vushtri, mbajtur më 26.7.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Ferit Idrizi, Gari Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana dhe Xhylsime Feka.

Munguan: Esat Beka, Zeqir Hasani, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** paraqiti rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë, kurse për "të ndryshme" propozoi që të futet Propozim-vendimi për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** lidhur me pikën e propozuar për rend dite në "të ndryshme", tha se propozimi në fjalë ka qenë edhe në KPF, dhe gjatë diskutimit në KPF janë paraqitur propozime që të gjenden mjete nga tjera burime për hartimin e strategjisë zhvillimore. Gjithashtu njoftoi se pas mbledhjes së KPF-së ka realizuar takim me ekspertët e USAID-it ku është arritur konstatim i përbashkët që hartimi i një strategjie zhvillimore të komunës duhet të procedohet përmes një kompanie profesionale, prandaj propozim-vendimi në fjalë përsëri iu është propozuar kuvendit, në mënyrë që nga fondi prej 25.000 € të barten vetëm 10.000 €, dhe të shpallet tenderi, në mënyrë që të përzgjedhet një kompani, e cila do ta hartojë strategjinë zhvillimore.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** foli në pika të shkurta për jetën dhe veprën e poetit të ndjerë Ali Podrimjes. Gjithashtu propozoi që kuvendi i komunës të mbajë një minutë heshtje për poetin e ndjerë Ali Podrimja, në nderim të shembëlltyrës së tij.

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** duke përkrahur propozimin e S.Kadriut, ftoi të gjithë të pranishmit në kuvend për një minutë heshtje në nderim të poetit Ali Podrimja.

**Pas mbajtjes së 1 minuti heshtjeje, vazhduan punimet e kuvendit.**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** lidhur me pikat 2 dhe 4 të rendit të ditës, pyeti kryetarin e komunës pse nuk kanë kaluar përmes KPF-së?

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar pyetjes së R.Ramaj, lidhur me raportin për situatën ekonomiko-financiare, tha se edhe në KPF ka diskutuar për raportin në fjalë, dhe shtoi se gjatë hartimit të planit të punës së kuvendit është bërë një gabim, pasi që është e vështirë që të përgatitet raporti 6-mujor menjëherë pas përfundimit të muajit të gjashtë dhe të procedohet për KPF dhe kuvend, prandaj ka propozuar që në të ardhmen të mbetet raporti në fjalë për muajin shtator. Kurse sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore, tha se me ligj obligohet KPF-ja që ta organizojë dëgjimin publik për çështjen në fjalë, duke njoftuar se dëgjimi publik është realizuar, prandaj nënkuptohet se KPF-ja është e njoftuar.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e mbështet rendin e ditës, kurse nuk e mbështet pikën shtesë të propozuar në “të ndryshme”, pasi që rikujtoi që edhe më herët kanë paraqitur vërejtje lidhur me pikat shtesë që propozohen, duke mos respektuar procedurat adekuate. Në fund njoftoi se pikën shtesë nuk e mbështesin dhe nuk do të marrin pjesë gjatë diskutimit për pikën në fjalë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar pikës shtesë të propozuar në “të ndryshme” tha se kjo pikë është diskutuar edhe në KPF, por nuk është përkrahur pasi që kanë qenë të propozuara të ndahen 25.000 €, dhe kemi propozuar që të ndahen më pak mjete, prandaj tani Grupi parlamentar i PDK-së e mbështet pikën shtesë, pasi që ka ardhur propozimi i ri në vlerë prej 10.000 €.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se nuk pajtohet me arsyetimet që i paraqiti kryetari i komunës lidhur me pyetjet e R.Ramaj dhe shtoi se këtu ka bërë lëshim edhe KPF-ja, pasi që ka lejuar që të procedohen për kuvend këto dy pika kaq të rëndësishme, pa i marrë në shqyrtim. Pastaj duke iu referuar nenit 52.2 të LVL-së, dhe nenit 54 të Statutit të Komunës në mënyrë të qartë i përcakton përgjegjësitë e KPF-së, prandaj kështu siç është vepruar, ka ndodhur shkelja e LVL-së dhe e Statutit të Komunës. Në fund tha se kryetari i komunës dhe ne (anëtarët e kuvendit) duhet të jemi mbrojtës dhe garantues të zbatimit të LVL-së dhe Statutit të Komunës.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** lidhur me diskutimin e B.Jasharit, tha se nuk është bërë shkelje e LVL-së, duke shtuar se neni 21 “b” e Rregullores së Punës së Kuvendit e lejon mundësinë që në fillim të mbledhjes (në raste urgjente) të shpërndahen materiale.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 21 vota “për”, të tjerat “abstenim” miratoi këtë:**

## **R E N D I T E**

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012.**

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për vitin 2013 (shqyrtimi i parë).
4. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore i Komunës (KAB) së Vushtrrisë për periudhën 2013-2015 (shqyrtimi i parë).
5. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: Janar-Qershor 2012.
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Raportin e Auditimit të Komunës së Vushtrrisë nga Auditori i Përgjithshëm për vitin 2011.
7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për binjakëzim në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Vaxjö-sit të Suedisë.
9. Shqyrtimi i kërkesës nga shoqata HANDIKOS (dega në Vushtri) për ndihmë me mjete materiale.
10. Të ndryshme:
  - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale;
  - b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

### 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

*Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së KK-së, pa vërejtje dhe sugjerime.*

### 2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, tha se edhe më herët ua kemi tërhequr vërejtjen lidhur me planin e punës së kryetarit për vitin 2012 (i cili nuk është prezantuar në kuvend, por vetëm përmes ueb-faqes së komunës), dhe qysh atëherë kemi thënë që plani i punës së kryetarit është një plan i përgjithësuar që lë vend për manovrim dhe shmangie gjatë raportimeve të kryetarit. Tutje tha se kjo për neve është e papranueshme, prandaj qysh atëherë kemi thënë që plani i punës duhet të jetë i specifikuar me detyra dhe afate, në mënyrë që kuvendi i komunës të ketë mundësi të bëjë matje të përmbushjes së detyrave dhe objektivave që i ka paraparë kryetari në planin e tij të punës, dhe shtoi se nëse i referohemi planit të punës së kryetarit, ka shmangie të madhe të përmbushjes së detyrave të parapara me plan, pasi që disa drejtori nuk kanë bërë afatizim të detyrave që i kanë planifikuar, ndërkaq si shembull konkret përmendi Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport. Pastaj lidhur me ekonominë, tha se gjatë këtij sezoni shumë fermerë të Komunës së Vushtrrisë kanë hedhur një sasi jashtëzakonisht të madhe të patateve në lumin "Silnica", dhe askund në raport nuk flitet se komuna është interesuar që t'i përkrah këta fermerë për t'i evituar pasojat e dëmeve të shkaktuara, dhe shtoi se vetëm Drejtoria për Ekonomi iu ka referuar pikave të planit të vet të punës për vitin 2012. Gjithashtu tha se shumë projekte që janë paraparë janë realizuar me vonesë, ose janë realizuar me cilësi shumë të dobët. Mandej tha se shumë projekte janë në zvarritje dhe shumë rrugë po "harrnohen" dhe vazhdimisht ka pakënaqësi tek qytetarët se nuk po kryhen punët siç duhet, prandaj kjo gjendje duhet të jetë shqetësim për autoritetet e komunës. Në vazhdim tha se asnjë fjalë nuk flitet në raport se sa: ka pas të punësuar gjatë kësaj periudhe në Komunën e Vushtrrisë; investime janë bërë (nga sektori privat) në Komunën e Vushtrrisë, duke shtuar se sektori privat është gjenerator i punësimit dhe krijimit të vendeve të punës, dhe kërkoi që pushteti komunal t'i përkrah bizneset me

aq sa ka mundësi. Mandej tha se si Grupi parlamentar i LDK-së kanë ngritur shqetësimin lidhur me cilësinë e punimeve, dhe si shembuj të keq janë përmendur rastet e rrugëve në Bukosh dhe Tërllabuq. Pastaj lidhur me raportin në fjalë, tha se drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim ankohet se ka vështirësi për reagimin e zjarrfikësve, pasi që nuk janë respektuar standardet e ndërtimit dhe janë ndërtuar ndërtesat shumë afër njëra me tjetrën, prandaj pyeti kush i dha lejet që të ndërtohen ndërtesat aq afër njëra me tjetrën?, duke shtuar se vet pushteti komunal po i jep ato leje.

**Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit-** në raportin në fjalë thuhet se "ka pajisje të duhura laboratorike, rëntgen të filmave dhe pajisje për stomatologji", prandaj tha se çështja e laboratorit dhe rëntgenit nuk qëndron mirë, sepse shumëherë mbesim në periudhë shumë të gjatë pa iu kryer analizat e duhura qytetarëve dhe pa i kryer rëntgenët e paraparë për pacientët e shtrirë dhe pacientët ambulatorë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se në këtë raport janë pasqyruar punët që janë bërë dhe që janë duke u bërë, punë të cilat janë realizuar dhe janë duke u realizuar në përputhje me planifikimin buxhetor për vitin 2012, e të cilat janë aprovuar nga kuvendi i komunës. Pastaj tha se gjatë këtij viti ka qenë një gjendje emergjente gjatë stinës së dimrit, ku falë punës së mirë të organeve komunale dhe përkrahjes së qytetarëve ka kaluar me sukses. Gjithashtu tha se po punohet në çdo cep të qytetit dhe nëpër fshatra, duke shtuar se janë ndërtuar dhe janë duke u ndërtuar rrugë, kanalizime, ujësjellës, shkolla, ambulanta, sheshe dhe hapësira gjelbëruese, të cilat për çdo ditë ua përmirësojnë jetën qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Po ashtu tha se gjatë kësaj periudhe janë në ndërtim e sipër 24.010 m rrugë me asfalt; 4.000 m<sup>2</sup> rrugë me kubëza dhe trotuare; 2.640 m<sup>2</sup> kanalizim fekal dhe atmosferik; 7.050 m<sup>2</sup> hapësira për gjelbërim; është duke u ndërtuar shkolla në Zhilivodë; është rinovuar dhe inventarizuar shkolla në Samadrexhë; është ndërtuar ura mbi lumin "Silnicë" në fshatin Prelluzhë; është duke u ndërtuar objekti i ri i komunës, si dhe fabrika e ujësjellësit, që është jetike për qytetarët. Tutje ai tha se Komuna e Vushtrrisë për çdo vit ndanë mjete për skamnorët për ndërtimin e shtëpive, ndihma financiare dhe ndihma të ndryshme, dhe po ashtu komuna është duke paguar qira mujore për disa familje, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e strehimit. Kurse tha se Komuna e Vushtrrisë ka ndarë mjete edhe sportin dhe rininë e qytetit të Vushtrrisë, duke i subvencionuar të gjitha klubet sportive që marrin pjesë në gara në nivel vendi dhe ndërkombëtar, në vlerë prej 29.600 €; gjithashtu janë ndarë mjete për shoqatat e dala nga lufta dhe shoqatat tjera në vlerë prej 10.800 €; si dhe ndihma momentale për familjet skamnore. Në fund tha se bulevardi "Dëshmorët e Kombit" ka qenë premtim para elektoratit nga PDK-ja dhe është duke u realizuar.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se në disa pika paraqet gjendjen e punëve, aktiviteteve të zhvilluara në aspektin financiar dhe ekonomik, si dhe të planeve investuese, mirëpo është shqetësuese cilësia e punimeve, prandaj kërkojmë që të ketë kualitet të punës në të gjitha objektet dhe punimet, pasi që është në pyetje taksa e qytetarëve, dhe shtoi se ka edhe shumë zvarritje në realizimin e projekteve. Gjithashtu tha se është obligative kontrollimi i kualitetit të punëve dhe të zbatimit të kontratave, si dhe zbatimi i dispozitave ligjore ndaj atyre që nuk i respektojnë afatet e kontratave, dhe kërkoj që të largohen ato firma që nuk i përmbahen kualitetit.

**Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit-** lidhur me raportin në fjalë, tha se është mirë që po shtrohen rrugë, por duhet vlerësuar cilësia e tyre, prandaj pyeti kryetarin e komunës se a po zbatohen standardet dhe cilësia në shtrimin e asfalteve dhe a po zbatohen të dhënat kadastrale, sepse disa rrugë shumë ngushtë po shtrohen, pasi që janë uzurpuar rrugët dhe po iu vështirësohet jeta qytetarëve.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se tre sektorët (arsimi, pylltaria dhe kultura) kanë mbetur prapa, pasi që nuk po përkrahen

sa duhet sektorët në fjalë, kurse te Drejtoria për Arsim është dashtë të përmendet pse nuk janë emërtuar 6 shkolla, pasi që akoma janë pa emra. Gjithashtu tha se pasi që ka suksese nga shkollat, është dashtë të përmendet suksesi i shkollës së mesme të ulët "Bahri Kuçi", pasi që në gara republikane i kanë fituar dy vendet e para. Kurse te sektori i pylltarisë, tha se ka mangësi pasi që nuk ka investime sa duhet, kurse pyjet po prehen, ndërsa pylltarët po rrahen, prandaj është dashtë të ketë një raportim real. Në fund tha se është dashtë të paraqitet një arsyetim nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pse është shtyrë për muajin shtator manifestimi "Takimet e Poeteshave Shqiptare".

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se raporti në fjalë nuk mund t'i përfshijë të gjitha punët. Pastaj duke iu referuar vërejtjes lidhur me patatet e humbura, tha se është për keqardhje që ka ndodhur, mirëpo nuk është menaxhimi i dobët i komunës që ka ndikuar tek humbja (hedhja) e tyre. Kurse lidhur me vërejtjen për realizimin e projekteve me zvarritje, tha se ka disa projekte që zvarriten, mirëpo projektet kryesore që do të realizohen nuk do të lejojmë që t'i zë stina e dimrit të papërfunduara. Mandej tha se edhe vet në cilësinë e kryetarit të komunës nuk është i kënaqur në ndonjë rast me cilësinë e punimeve, por së bashku me qeverinë komunale është duke bërë presion maksimalisht që punët të kryhen me cilësi dhe dinamikë. Në fund tha se është e pamundur që gjatë mandatit të tij t'i zgjidh të gjitha problemet që i ka pasur Komuna e Vushtrrisë në fushën e ndërtimitarisë.

### **3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, për vitin 2013 (shqyrtimi i parë).**

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqet këto vërejtje: te neni 6 thuhet: "prona komerciale e ka normën e tatimit 0.20 %", gjithashtu edhe "prona e pameremetuar e ka normën e tatimit 0.20 %", dhe shtoi se nuk duhet ta kenë normën e njëjtë. Gjithashtu tha se është pajtuar me rekomandimet e anëtarëve të KPF-së që pishinat dhe fushat sportive të kenë normë të veçantë të tatimit; te "pronat rezidenciale (banesë-apartament)" dhe "pronat rezidenciale-shtëpi" propozoi që të ulet norma; te neni 8.1 propozoi që zona e parë të ndahet në dy kategori (nënzona); lidhur me nenin 8.4 tha se nuk ekzistojnë plane urbanistike për asnjë fshat në Komunën e Vushtrrisë, prandaj propozoi që në zonën e katërt të hyjnë me emër fshatrat konkret, kurse në zonën e pestë të hyjnë fshatrat që gjenden më larg qytetit.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, pyeti pse nuk ka ndryshim të politikave lidhur me të hyrat e tatimit në pronë. Pastaj tha se në shtetet demokratike ka kritere tjera në bazë të të cilave caktohen të hyrat e komunave dhe shumat e tatimeve, prandaj pyeti pse nuk merret si kriter çështja e amortizimit, pasi që ky kriter aplikohet në shtetet e zhvilluara dhe njëkohësisht sipërfaqet e banesave për kokë të banorit. Në fund kërkoi që të zbatohet një kriter ligjor, e që është verifikimi i sipërfaqeve të pronave, pasi që tek ne nuk është real, pasi që tatimohen sipërfaqe më të vogla se sa që janë në realitet.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah draft-rregulloren në fjalë, kurse koeficientët dhe amortizimet janë të parapara me ligj, prandaj Grupi parlamentar i PDK-së kërkon që të harmonizohen zonat në bazë të planit urban, që është miratuar në kuvendin e komunës në vitin 2009.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2013 në territorin e Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 27.07.2012 dhe zgjatë deri më 03.09.2012.***

#### **4. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore i Komunës (KAB) së Vushtrrisë për periudhën 2013-2015 (shqyrtimi i parë).**

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me draft-kornizën në fjalë.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah hartimin e draft-kornizës në fjalë, dhe shtoi se kjo draft-kornizë karakterizohet si kornizë më e avancuar në krahasim me të deritanishmet, edhe pse në brendi ka disa ngatërime konceptuale, ka gabime të pajustificueshme në kalkulime, si dhe ka një analizë (shumë të mirë) profesionale të parashikimit të riskut. Kurse në faqen 3, aty ku thuhet se “Vushtrria është e njohur sidomos me prodhimin e patates së kualitetit të lartë”, propozoi që t’i shtohet fjalia “dhe me përpunimin e saj”. Gjithashtu tha se në kornizë duhet të pasqyrohet një përqindje e strukturës së ndërmarrjeve prodhuese, pasi që participimi i strukturës së prodhimit është shumë me rëndësi në një kornizë. Ndërsa lidhur me vizionin, propozoi që të riformulohet në këtë mënyrë: “Vizioni, Vushtrria qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik me urbanizëm modern, shërbime efikase dhe kualitative, e integruar në proceset rajonale ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, duke ofruar kualitet të kënaqshëm të jetesës për qytetarët e saj”. Mandej tha se përderisa vizioni është i shkëlqyeshëm, në faqen 4, tri formulimet e zbehin vizionin, dhe propozoi që para pikës së dytë “mbështetjes direkte të sektorit bujqësor, pylltarisë e blegtorisë”, të jetë kjo pikë “krijimit të një ambienti të favorshëm ndërmarrës”, dhe pas mbështetjes direkte, të jetë “mbështetje industrisë përpunuese”; te nr.2 “përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve”, tha se ka ngatërrim konceptesh. Në vazhdim tha se duhet të paraqitet sqarim rreth fjalisë: “komuna në periudhën afatmesme buxhetore 2013-2015 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie”. Po ashtu tha se nga tabelari nr.1 mund të konkludohet se çdo e teta ekonomi familjare ka biznes në Vushtrri, çdo i 45-ti banor ka biznes aktiv, prandaj kjo flet për “shpirtin” e ndërmarrësisë të Komunës së Vushtrrisë, ndërkaq realiteti është ndryshe, dhe shtoi se këto shifra duhet të materializohen në funksion të zhvillimit, sepse për nga numri i bizneseve, ka një tabelar shumë të mirë. Te planifikimi i të hyrave vetanake, tha se ka gabime në kalkulime te shtylla e tretë dhe e katërt (vlerësimet për vitin 2014 dhe 2015), kurse përkundër asaj që është rritur me 41 % pjesëmarrja e subvencioneve për vitin 2012, por në strukturën e përgjithshme mbetet vetëm me 1.2 %, e që është shumë e vogël, prandaj duhet të jetë të paktën 3 %. Në fund tha se tabela nr. 7 ka gabime në kalkulime (përveç në shtyllën e tretë), tabela nr. 8 ka gabime në kalkulime, kurse tabela nr.9 ka gabime në kalkulime në këto shtylla: 1, 5 dhe 6. Gjithashtu tha se ka gabime në kalkulime edhe te lista e projekteve kapitale për vitin 2013.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-kornizës në fjalë, tha se nëse nuk janë shumë parametra që i përcaktojnë kahjet e zhvillimit, atëherë është vështirë të paraqiten disa shënime të sakta dhe orientime të sakta rreth zhvillimit të mëtutjeshëm, dhe shtoi se Komuna e Vushtrrisë akoma nuk e ka të qartë sa e ka numrin e banorëve. Pastaj duhet të dihet saktësisht struktura e bizneseve, dhe lidhur me faqen nr, 7 pyeti se a është real planifikimi i të hyrave për periudhën 2013-2015, kurse lidhur me taksat për certifikatë të vdekjes, pyeti se nga të gjitha këto taksa dhe a është taksa e njëjtë për këtë çështje, pasi që në këtë 6 muajor janë vetëm 905 certifikata të vdekjes, dhe prej tyre 494 certifikata pa pagesë, prandaj pyeti si mundën me qenë 60.000 € brenda vitit? Gjithashtu tha se akoma nuk janë të qarta politikat sociale (kompetencat) për komuna, prandaj një problem i tillë është serioz. Në vazhdim tha se ka rritje në subvencione dhe ndihma sociale, kurse ka rënie në kategorinë e investimeve kapitale në vitin 2013 për 7.06 %, dhe pyeti se çfarë përmirësime do të ketë në këtë drejtim? Në fund tha se duhet të kemi një kornizë

reale, të balancuar dhe të qëndrueshme buxhetore për vitet e përcaktuara 2013-2015, në mënyrë që të mos oscillohet me dëshira apo synime të paverifikuara, por të jenë ato që mundësojnë një zhvillim harmonik të komunës.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit**- duke iu referuar faqes nr. 7 të draft-kornizës në fjalë lidhur me paragrafin: "Komuna e Vushtrrisë vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare, të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 85 % të buxhetit total të komunës", ku pyeti se a ka bërë ndonjë analizë drejtoria përkatëse dhe kryetari, në mënyrë që kjo gjendje të ndryshohet, që buxheti i Komunës së Vushtrrisë të mos dominohet në këtë përqindje kaq të lartë nga transferet qeveritare. Pastaj te faqja nr. 8 thuhet: "Komuna nuk ka të planifikuar donacione të jashtme në periudhën afatmesme buxhetore 2013-2015, meqë nuk ka marrëveshje të nënshkruar me ta eventualisht dhe zotime paraprake", prandaj pyeti çka kanë ndërmarrë autoritetet kompetente që të orientohen kah donatorët e mundshëm të jashtëm?

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**- tha se draft-korniza në fjalë është një dokument tepër i rëndësishëm për Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tha se nuk mund të figurojë në draft-kornizë se komuna nuk pranon hua, pasi që marrja e huasë komunës i mundësohet përmes ligjit. Mandej tha se është ide e mirë që të mos zvogëlohen investimet kapitale, por që 2-3 vite në mallra dhe shërbime ka pas shumë pak mjete, mirëpo gjatë këtij viti situata emergjente gjatë stinës së dimrit na ka detyruar që të shpenzojmë mjete të konsiderueshme financiare. Kurse lidhur me numrin e banorëve të Komunës së Vushtrrisë, tha se serbët nuk kanë pranuar të regjistrohen dhe pa i llogaritur serbët, në Komunën e Vushtrrisë banojnë afër 70.000 banorë. Në vazhdim lidhur me të hyrat vetanake, tha se ka qenë një mënyrë e jo e drejtë nga Ministria e Buxhetit në ngarkim të komunave për të hyrat vetanake. Në fund tha se shumë rrugë dhe shkolla janë ndërtuar në komunë pa planifikim, falë donacioneve nga Qeveria e Kosovës.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KAB-i) së Vushtrrisë për periudhën 2013-2015.***

***Diskusimi publik fillon nga data 27.07.2012 dhe zgjatë deri më 03.09.2012.***

**5. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: Janar- Qershor 2012.**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit**- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se Grupi parlamentar i LDK-së e ka analizuar dhe nga tabelarët (duke hequr donacionin e brendshëm prej 12.543 €) del se komuna ka arritur t'i përmbledh të hyrat vetjake nga planifikimi vetëm 50.69 %, dhe ky fakt flet për një shkallë shumë të ulët. Pastaj tha se përveç raportimit standard, do të duhej një raport tjetër menaxherial, i thjeshtësuar, i detajuar dhe i shoqëruar me grafikone. Në fund në emër të Grupit parlamentar të LDK-së kërkoi nga kryetari i komunës dhe të gjithë vartësit e tij që të angazhohen, sepse kot hartohet edhe korniza, nëse shkon me këtë trend të realizimit të të hyrave vetjake.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit**- lidhur me informatën në fjalë, tha se kjo strukturë e anëtarëve të kuvendit ka nevojë që të ketë një informatë me shkrim, me tabelar dhe me diagrame më ndryshe në krahasim me nivelin profesional.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit**- duke iu referuar përgjigjes së kryetarit të komunës, tha se nuk është hera e parë që kryetari e ka përmend pakënaqësinë e tij lidhur me performancën e drejtorëve, prandaj pyeti kush ia zgjodhi këta drejtorë kryetarit?

## **6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me Raportin e Auditimit të Komunës së Vushtrrisë nga Auditori i Përgjithshëm, për vitin 2011.**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se këtij raportit nuk i beson, sepse ky raport nuk ka kualifikim profesional, pasi që ky raport është i ndikuar, dhe shtoi se auditorët kanë presione, kërcënime dhe nga frika për të mos e humbur vendin e punës, ata vet i përmirësojnë shumë gjëra që e prishin kualifikimin. Pastaj i sugjeroi kryetarit të komunës që për vitin e ardhshëm të angazhojë Deloitte Touche ose Grant Thornton-in për t'i audituar pasqyrat financiare. Në vazhdim tha se në këtë raport janë disa konkluzione që ka rekomanduar për t'u përmirësuar, ndër to përmendi shënimin 29: Detyrimet kontingjente nuk janë shpalosur në vlerë prej 58.750 €, dhe shtoi se auditori nuk ka hasur vetëm në këtë vendim gjyqësor, por ka edhe konteste tjera, prandaj ka detyrime kontingjente që e arrijnë shumën mbi 1 milion euro, e që është dashtë të figurojnë në pasqyrat financiare. Kurse lidhur me "mos raportimin e shpenzimeve nga përfituesit" (faqe nr. 17 të raportit në fjalë), tha se subvencionet që po i marrin organizatat e ndryshme, po i përfiton vetëm nga një person (zyrtar) i organizatave në emër të pagave personale. Gjithashtu tha se asetet kanë deviacion me dhjetëra milionë euro. Në fund tha se ky raport nuk është real.

**Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit-** tha se nga raportit në fjalë po nënkuptohet se Komuna e Vushtrrisë radhitet ndër 12 komunat më të suksesshme të Kosovës, prej 36 Komunave të Kosovës, dhe shtoi se auditorin e përgjithshëm nuk e ka caktuar as qeveria komunale dhe as kryetari i komunës.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** lidhur me raportin në fjalë, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së kërkoi që të bëhet zbatimi i rekomandimeve ashtu siç janë dhënë me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet dhe një nga to është edhe moskryerja e objekteve dhe zbatimit të kontratave, ndërsa si shembull konkret përmendi urën mbi lumin "Silnica" në fshatin Prelluzhë, ku sipas kontratës është paraparë që të përfundojë me 12.11.2011, por ajo ende nuk është kryer. Mandej tha se po ndahen subvencione për klube të ndryshme, por asnjëherë nuk ka informata kthyese. Pastaj është thënë se punësimi i punëtorëve po ndodh pa emra, pa kontrata, pa procesverbale dhe pa dokumente origjinale, prandaj kjo nuk mund të ndodh në institucionin e komunës. Në fund tha se është shqetësuese menaxhimi i mirëfilltë i pronave, dhe shtoi se edhe si të tilla këto rekomandime kanë peshën e vet, prandaj duhet të merren parasysht.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se Auditori Gjeneral e ka vlerësuar kryetarin e komunës dhe qeverinë lokale me notën më të lartë me opinionin e pakualifikuar dhe ky vlerësim po vjen që dy vite radhazi, ku shtoi se 80 % të rekomandimeve nga viti i kaluar janë përmbushur. Kurse lidhur me vërejtjen e dhënë për subvencione, tha se në vitin e kaluar është aprovuar rregullorja për ndarjen e këtyre mjeteve dhe se në këtë vit të gjithë përfituesit e mjeteve kanë sjellur raporte për shpenzimet e tyre. Ndërsa lidhur me vërejtjen për ndarjen e mjeteve për Organizatën e Veteranëve të UÇK-së (për shënimin e ditës së Zonës së Shalës), tha se vitin e kaluar kërkesa e tyre ka ardhur si pikë shtesë e rendit të ditës, pasi që ka qenë kërkesë urgjente, kurse këtë vit kërkesa e natyrës së njëjtë ka ardhur me kohë, duke respektuar të gjitha procedurat. Në fund tha se PDK-ja (përmes qeverisjes lokale) brenda 4 viteve ka arritur të: asfaltojë 185 km rrugë; shtrojë 21.000 m rrugë me kubëza; 40.000 m kanalizim; 86.000 m ujësjellës; janë realizuar afro 600 projekte të mëdha ose të vogla.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se duhet të kihen parasysht nga komuna vërejtjet e paraqitura nga Auditori Gjeneral, duke filluar nga vërejtja faqe nr. 6, pastaj është dhënë vërejtje se sistemi i kontrollit të brendshëm të komunës nuk ka funksionuar siç duhet. Mandej tha se në bazë të raportit, auditori ka gjetur se komuna nuk ka siguruar që pasqyrat vjetore financiare



të jenë në pajtim me rregullat financiare. Kurse lidhur me "menaxhimin financiar – të hyrat" në raport thuhet se: "përkundër faktit se komuna kishte të hyra të inkasuara 94 %, 34 % e këtyre të hyrave janë bart në vitin 2012", pasi që ka munguar planifikimi i mirëfilltë i shpenzimit të tyre. Ndërsa lidhur me "shpenzimet", në raport është dhënë vërejtje se janë bërë pagesa nga prokurimi pa raporte të pranimit, prandaj shtoi se kjo është bazë për dyshim se mund të bëhen keqpërdorime, pasi që rregulli e kërkon që të ketë raport të pranimit dhe të bëhet pranimi me komision. Gjithashtu tha se është shqetësuese vërejtja e auditorit të përgjithshëm lidhur me "shpenzimin e parasë pa procedura të prokurimit dhe mungesës së dëshmimeve". Në fund e ftoi kryetarin e komunës dhe ekzekutivin që rekomandimet dhe vërejtjet që janë paraqitur në raport të adresohen drejt dhe të mos përsëritën, pasi që ka raste që po përsëritën rekomandimet e vitit 2010 edhe në vitin 2011.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se Zyra e Auditimit bën auditime në të gjitha institucionet në nivel qendror dhe në të gjitha komunat në çdo vit fiskal. Pastaj tha se pasqyrat financiare janë të hartuara në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit publik të shprehur në parane e gatshme, prandaj është e pamundur që lexuesi t'i kuptojë dhe shtjellojë të gjitha pasqyrimet e paraqitura në raport. Në vazhdim tha se është i kënaqur me punën që e ka bërë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, kurse për rekomandimet që i ka dhënë, njoftoi se në bashkëpunim me kryetarin e komunës janë duke përgatitur planin e veprimit për rekomandimet në fjalë.

#### **7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).**

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqiti këto propozime: te neni 20.2, propozoi që t'i shtohet kjo fjali "përveç rasteve (rrethanave) të caktuara"; te neni 22.2, propozoi që Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për të gjithë qytetarët, prandaj propozoi që këto shpenzime të planifikohen me buxhet; te neni 40, pyeti se kujt duhet t'i bëhet pagesa (kompanisë, bashkësisë fetare apo komunës); te neni 42.3, propozoi që të thuhet: "një operator tjetër".

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e mbështeti draft-rregulloren në fjalë. Gjithashtu paraqiti këto vërejtje: te neni 4, propozoi që në ato vendbanime ku është një konfeksion fetar, të ketë vetëm një lokacion për varreza; te neni 22, propozoi që të sqarohet se kush e bën varrosjen e tyre.

**Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti vërejtje lidhur me nenin 25.1, ku tha se kufoma e të vdekurit nuk mund të zhvarroset, ajo mund të zhvarroset vetëm me kërkesën e organeve përkatëse (prokurorit dhe organeve të gjyqit) në rastet e ekspertizës dhe verifikimit të fakteve që i nevojiten legjislativit. Gjithashtu te paragrafi 25.3, propozoi që fjala "sanitar" të zëvendësohet me fjalën "ligjor".

**Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar propozimit që Komuna e Vushtrrisë t'i mbulojë shpenzimet për çdo të vdekur të komunës, tha se gjatë vitit 2011 kanë vdekur afro 400 njerëz, prandaj komuna nuk mund t'i përballojë shpenzimet e tilla.

**Sami Istrefi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike-** tha se mungesa e Ligjit për Shërbimet e Varrimit ka ndikuar që në tërë territorin e Kosovës të rregullohet kjo çështje vetëm përmes një rregulloreje, sepse po të kishte ligj do të ishin ndarë kompetencat e komunës, bashkësisë fetare apo të ndërmarrjes. Pastaj tha se gjatë shqyrtimit të parë, janë përfshirë shumica e propozimeve nga anëtarët e kuvendit, gjithashtu janë inkorporuar shumica e propozimeve të paraqitura nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Vushtrrisë. Kurse lidhur me propozimin që Komuna e Vushtrrisë

t'i mbulojë shpenzimet e varrimit, tha se mungesa e mjeteve financiare të komunës e pamundëson realizimin e propozimit të tillë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Aprovohet Rregullorja për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke inkorporuar edhe propozimet dhe vërejtjet e anëtarëve të kuvendit.**

**8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për binjakëzim në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Vaxjës të Suedisë.**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se kishte me qenë mirë po të kishte ndonjë shkresë formale edhe nga ana e Komunës së Vaxjës të Suedisë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë vendos marrëdhënie të binjakëzimit me Komunën e Vaxjës me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe realizimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të dy komunave në fjalë në fusha të ndryshme.**

**9. Shqyrtimi i kërkesës nga shoqata "HANDIKOS" (dega në Vushtrri) për ndihmë me mjete materiale.**

**Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të LDK-së tha se kemi obligim moral që ta përkrahim shoqatën "Handikos", pasi që është kërkesë e arsyeshme dhe e nevojshme, meqë kërkesa në fjalë përfshin dy segmente: arsimin dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore për personat me nevoja të veçanta në Komunën e Vushtrrisë. Në fund propozoi që Handikos-i ta bëjë një kërkesë dhe Komuna e Vushtrrisë ta merr në mbështetje në kuadër të drejtorisë për ta mbikëqyrur dhe përkrahur.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e përkrahu kërkesën në fjalë, dhe shtoi se kjo pjesë e shoqërisë meriton një tretman më të veçantë nga e gjithë shoqëria.

**Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit-** në emër të Grupit parlamentar të PDK-së e përkrahu kërkesën në fjalë.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Shoqatës "HANDIKOS" dega në Vushtrri i ndahen mjete financiare në shumë prej 2.160 € (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë euro) nga Fondi për Transfere dhe Subvencione i buxhetit të komunës për ushtrimin e veprimtarisë së saj.**

**10. Të ndryshme:**

**a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore në investime kapitale;**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Me këtë vendim bëhet ridestini i mjeteve buxhetore nga projekti kapital për blegtori (me kodin e kategorisë 644470 dhe nënkodin e projektit 644470-1214757)**

*në investimin e realizimit të një projekti tjetër kapital "Hartimi i Strategjisë Zhvillimore Komunale 2013-2018".*

*Në fondin në fjalë është shuma prej 25,000 euro, dhe nga kjo shumë ridestinohet shuma prej 10,000 euro për realizimin e projektit të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, i cili projekt duhet të përfundojë brenda vitit 2012.*

**b. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** i propozoi Drejtorisë për Shërbime Publike që të mbyllë përkohësisht për qarkullim (prej orës 20:00-24:00) rrugën "Pandeli Sotiri", pasi që është një rrugë ku ka shumë lokale dhe frekuenton një numër i madh i rinjve. Gjithashtu kërkoi që kryetari i komunës në bashkëpunim me komandantin e stacionit të policisë ta shtojnë kontrollin dhe mbikëqyrjen e sigurisë, pasi që mundësitë janë që të ndodhin edhe probleme. Në vazhdim i propozoi Drejtorisë për Shërbime Publike që çdo rrugë që kryqëzohet me rrugën kryesore të vendosen shenja që tregojnë rrugën e caktuar. Në fund paraqiti një vërejtje ndaj kryetarit të komunës, pasi që në seancën e 31 majit ka kërkuar përgjigje nga kryetari për premtimin që ia ka dhënë zv. ministrit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për faktin e konstatuar (nga divizioni përkatës) se në Vushtrri ekziston një fryrje e numrit të përfituesve të ndihmave sociale, prandaj shtoi se ka kërkuar të informohet nga kryetari se a e ka përmbushur premtimin se do të hiqen nga lista përfituesit jomeritor të ndihmave sociale dhe të merren në përgjegjësi ata që i kanë futur në lista përfituesit jomeritor.


**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-** propozoi që të hyn në planifikim: ndërtimi i rrugës Studime e Ulët-varrezat e qytetit; renovimi i shkollës fillore "Bahri Kuçi" në Shtruherë; ndarja e bursave për studentët. Në fund pyeti çfarë ndodhi me lllaptopët, pasi që u premtuan dhe u mor vendim në kuvend për ta.

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit-** ngriti çështjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, pasi që javët e fundit ka pas një shqetësim të qytetarëve, si rezultat i krizmave të pakontrolluara nëpër ahengje të ndryshme, ku është rrezikuar edhe jeta e qytetarëve. Në fund kërkoi nga Drejtoria për Shërbime Publike që ndër prioritetet e para për rrugët lokale të ndërtohet rruga nga institucioni i komunës e deri te Shtëpia e Mallrave, pasi që është pjesa më e shëmtuar e komunës.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë-** duke iu referuar çështjes së lllaptopëve, sqaroi se pasi që është marrë vendimi në kuvend për lllaptopët (për anëtarët e kuvendit), kurse tash USAID-i e ka për detyrë që ta shpallë tenderin dhe t'i siguron lllaptopët në bazë të vendimit të kuvendit.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:00.**

**Procesmbajtësi**

  
**Albanez Tahiraj**

**Lektore**

  
**Vlora Krasniqi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**  
